



Rigips Uniputz 75

Llaç mbushës/rrafshues me bazë gipsi natyror

Paketimi - 30kg, Paleta 40 thasë ose 1200kg

Ngjyra – Gri

Skandencia – 12 muaj pas datës së vendosur mbi thes.

Konsumi - 8 kg/m² për shtresë 1cm

Koha e tharjes – 24 orë për trashësi 1cm



Rigips Uniputz 75 - Informacion i përgjithshëm i produktit

Përshkrimi – Rigips Uniputz 75 është llaç mbushës/rrafshues me bazë gipsi natyror dhe rërë e përziejdhur me aditivë të shtuar për të përmirësuar punimin, ngjitjen, përpunimin dhe rrafshim.

Përdorimi - Rigips Uniputz 75 përdoret për suvatimin, drejtimin dhe rrafshimin e sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve, të brendshme me trashësi deri në 3 cm me një shtresë. Produkti karakterizohet nga granulimi 1,5mm me perfitimet si më poshtë:

- Punueshmëri e lartë
- Ngjitje shume e mirë me nënshtresën
- Lehtësi në aplikim, rrafshim dhe fërkim
- Fortësi pas tharjes
- Rezistencë ndaj lagështirës dhe në ambiente me tepërcë lagështie
- Transpirant dhe filtrues ajri
- Termoizolues
- Sipërfaqe finale shumë e rrafshët

Rigips Uniputz 75 mund të përdoret si shtresë finale pa patur kërkesa të larta cilësie për imtësinë e sipërfaqes. Mbi të mund të aplikoni direkt, stuko patinimi Webermur stuko për arritjen e cilësisë maksimale të sipërfaqes me një granulum super të imët.

Përgatitja e nënshtresës

Rigips Uniputz 75 aplikohet mbi sipërfaqen e tullave të qeramikes, bloqeve të betonit dhe sipërfaqeve të betonarmese. KUJDES, para aplikimit në betonarme, duhet të përdorni gjithmonë astar/bazë weberprim beton si urë lidhëse dhe për shmangien e shkeputjes së shtresës nga sipërfaqja e aplikuar. Nënshtresa duhet të pastrohet fillimisht nga pluhuri, lagështira, njollat a vajit apo myku që mund të krijohet në sipërfaqe. Në qoftë se nuk pastrohen mirë faktorët e lartpërmendur, çdo aplikim i gabuar do të sjellë ankesa për të cilat vetë aplikuesi do të jetë përgjegjës.

Temperaturat e aplikimit duhet të jenë mbi 5°C deri në 30°C dhe me lagështirë deri në 70%. Në aplikimet jashtë kufijve të lartpërmendur mund të krijohen tharje të shpejta, të ngadalta apo paraqitje e plasaritjeve që nuk janë në përgjegjësinë e prodhuesit. Mos e përdorni këtë produkt mbi sipërfaqe të drurit, plastikës apo metalit.

Përgatitja dhe aplikimi

Produkti ka një përzierje 25kg me 10-11 litra ujë ose në aplikimet me pompë me 300 litra ujë/ton.

Aplikim me dorë: përzieni materialin me 8 litra ujë në një enë të madhe me mikser elektrik, derisa të arrihet një masë e njëtrajtshme. Aplikoni materialin e përzier me mistri metalike duke e gjuajtur/hedhur në sipërfaqet e përgatitura.

Aplikim me makineri

Kontrolloni pompën e punës që të jetë në gjendje të mirë, e pastër dhe e lidhur shumë mirë me ujë të bollshëm dhe me rrymen elektrike. Mbushni depozitën e pompës me material dhe pasi të ketë material të bollshëm, filloni hedhjen e materialit në sipërfaqe. Gjate aplikimit caktoni edhe nevojën për ujë sipas trashësisë që del nga gryka e pompës. Aplikoni materialin nga poshtë lart dhe mbushni sipërfaqen e paracaktuar duke mbajtur gryken e pompës jo më larg se 10 cm nga sipërfaqja që do suvatoni. Në qoftë se ka nevojë për shtresa të tjera mbi 3 cm, atëherë duhet të aplikoni një shtresë tjetër jo më vonë se 3 orë nga shtresa e parë. Në bashkimet ee mureve me tavanet, mure me mure dhe beton me mure, duhet të përdoret patjetër rrjeta webertherm rrjete 145gr/m² duke vendosur të paktën 10 cm rrjetë mbi çdo krah. Në sipërfaqet me EPS duhet përdorur me përpara rrjeta e ngjitur me webertherm special, ngjitës polisteroli. Cepat e jashtëm të mureve përforcohen me këndore metalike të cilat janë niveluar dhe vendosur më përpara.

Pasi keni mbushur sipërfaqet, drejtoni sipërfaqen me mastar sipas trashësisë së kërkuar ose të paravendosur nga fashot e vendosura në mure. Pas 3 orësh mund të bëni pastrimin e sipërfaqes nga kokrrizat apo valëzimet e krijuara nga aplikimi dhe të bëni rrafshimin final me shpatull të gjerë 50 mm. Pas 24 orësh mund të bëni vendosjen e shtresave të tjera me webermur glet apo webermur stuko sipas kërkesës së investitorit për cilësinë e sipërfaqes.

KUJDES – Në qoftë se gjatë aplikimit vëreni ndryshime të cilësise së produktit, ju lutem ndërprisni menjëherë punën dhe njoftoni personin e kontaktit nga Saint Gobain Albania ose dërgoni email në adresën sales.albania@saint-gobain.com. Mos vazhdoni punën me të njëjtën datë prodhimi apo numër serial të vendosur mbi thes. Ju lutem ruani numrin serial të thesit dhe datën e prodhimit si të dhënat kryesore mbi produktin.

Tharja

Të ruhet nga ngrica gjatë tharjes për të shmangur tharjen me vonesë dhe plasaritjet. Të ruhet nga erërat dhe rrymat e ajrit për të shmangur tharjen e shpejtë. Plasaritje mund të paraqiten në mur në qoftë se në

ambientin e punës ka situata të lartpërmendura. Weber sugjeron që ambientet ku punohet të jenë të mbyllura paraprakisht dhe të mos ketë ndikim nga faktorët atmosferike.

Konsumi 8 kg/m² për shtresë 1cm

Koha e tharjes – 24 orë për trashësi 1cm

Veglat e punës

Malle metalike, Mistri, Mastar/Drejtues metalik, Pompë G3/G4/G5, rul, furçe. Veglat e punës duhet të pastrohen para dhe pas pune. Çdo mbetje e materialit nëpër vegla, ndikon në cilësinë e materialit dhe të punës.

Magazinimi dhe mirëmbajtja

Produkti duhet të vendoset brenda në magazinë, vend të mbuluar pa praninë e lagështirës dhe lagës nga uji. Edhe nëpër kantiere, produkti duhet të vendoset në vende të thata dhe pa praninë e lagështirës. Çdo ankesë që do të vijë në lidhje me faktorët e lartpërmendur, nuk do të merren parasysh si ankesa.

Paketimi

Thasë 30kg, Paleta 40 thasë ose 1200kg

Ngjyra – Gri

Skandanca – 12 muaj pas datës së vendosur mbi thes